


KRU BIFURKACIONI SH.A  
RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME PËR STIMULIM TË LEXUESVE -  
ARKËTUESVE



KOMPANIA RAJONALE E UJËSJELLËSIT  
REGIONAL WATER COMPANY  
**BIFURKACIONI SH.A**  
Ferizaj



Duke u bazuar në Nenin 30, Paragrafi 2 të Ligjit për Rregullimin e Shërbimeve të Ujit Nr. 05/L -042; Nenin 20 të Ligjit Nr-04-L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr-03/L-087 për Ndërmarrje Publike, dispozitave të nenit 130 të Ligjit Nr-06/L-016, për Shoqëri Tregtare; Rregulloren për Paga, Reprerentacion, Meditje, Denime, Stimulime dhe Shpenzime tjera; Rregulloren mbi Themelimin e Marrëdhënies së Punës si dhe Nenin 6 pika 2 e Statutit të Shoqërisë Aksionare Kompania Rajonale e Ujësjetjes Bifurkacioni SH.A, Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e mbajtur më 22.10.2022 miraton:

**RREGULLOREN MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE PËR STIMULIM DHE  
DESTIMULIM TË LEXUESVE – ARKËTUESVE**

**Neni 1**

**Dispozitat e përgjithshme**

Me këtë Rregullore përcaktohet kriteret themelore, për stimulim të arkëtuesve-lexuesve, të Departamentit të Shitjes (DSh) (në vazhdim: punëtorët e kësaj kategorie), për kryerjen e punëve dhe detyrave të punës sipas përshkrimit të paraparë në Rregulloren për Sistematizimin e Detyrave të Punës.

**Neni 2**

**Qëllimi i fushëveprimit**

Qëllimi kryesor i kësaj rregullore është përcaktimi i kornizës ligjore për stimulim dhe destimulim, me qëllim të realizimit të objektivave të kompanisë të parapara me Planin e Biznesit si:

1. Arritja e objektivave të parapara në procesin e faturimit dhe arkëtimit;
2. Trajtimi i drejtë i punëtorëve në kryerjen e punëve dhe detyrave të punës dhe stimulimin e tyre;
3. Plotësimi i standardeve minimale të shërbimeve;
4. Mbrojtja e interesave të kompanisë në përputhje me obligimet dhe të drejtat se saj;
5. Sjelljet e drejta në marrëdhënie e kontakt me konsumatorin;
6. Mbrojtja e interesave të konsumatorëve për të drejtat dhe obligimet e tyre;
7. Zvogëlimi i sasisë të humbjeve të ujit të pijes;
8. Eliminimi i keqpërdorimeve eventuale, të shpenzimit të ujit nga konsumatorët;
9. Zvogëlimi deri në eliminim i lidhjeve ilegale në rrjetin e ujit të pijes,
10. Leximi i saktë mujor i ujëmatësve të konsumatorët për ujin e pijes të shpenzuar,
11. Rritja e numrit të konsumatorëve që shfrytëzojnë ujin e pijes (konsumatorët e rinjë),
12. Rritja e sasisë së ujit të faturuar, përmes leximit të saktë të ujëmatësve

**Neni 3.**

KRU BIFURKACIONI SH.A  
RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME PËR STIMULIM TË LEXUESVE -  
ARKËTUESVE

**Kriteret e përgjithshme për përcaktimin e shkallës së stimulimit dhe de-stimulimit të lexuesve – arkëtuesve**

1. Paga mujore bazë për këtë kategori është përcaktuar në bazë të kontratës dhe detyrave të punës sipas Rregullores për Sistematizim të vendeve të punës dhe objektivave të përcaktuara sipas planit të arkëtimit dhe faturimit.
2. DSh ka për detyrë të bëjë përgatitjen e planit të faturimit duke marrë si pikë orientuese objektivat e parapara me Plan të Biznesit.
3. Hartimi i planit të faturimit dhe arkëtimit ka për qëllim arritjen e objektivave të Planit të Biznesit.
4. Pas përfundimit plani i dorëzohet Kryeshefit Ekzekutiv (KE) për miratim final.
5. Plani i faturimit dhe arkëtimit hyn në fuqi, ndryshohet dhe plotësohet me Vendim nga ane e KE.
6. Plan i faturimit dhe arkëtimit mund të ndryshohet sipas nevojës dhe kërkesës së KE.

**Neni 4**

**Përcaktimi i kritereve bazë për të ardhurat personale (pagës), stimulimit dhe de-stimulimit**

1. Të ardhurat personale - Paga bazë për këtë kategori të punëtorëve për një (1) muaj është 342 € apo thënë ndryshe koeficienti i pagës është 6 (gjashtë) dhe vlera e koeficientit 57€ (pesëdhjetë e shtatë) ( $6 \times 57 = 342$ )<sup>1</sup>
2. Arkëtuesit-Lexuesit do të stimulohen me nga 30€ (tridhjetë euro) shtesë për çdo muaj me rastin e arritjes së kuotës së leximit e ujëmatësve e cila përcaktohet me këtë rregullore dhe plan të faturimit dhe arkëtimit deri në hyrjen në zbatim të faturimit mobil.
3. Çdo njoftim për konsumator ilegal dhe kyçje bypass të cilat vërtetohen nga komisionet stimulohen me 5€ (pesë euro).
4. Realizimi i objektivave sipas planit 100% nga ana e punonjësve do të stimulohen në të ardhura sipas nenit 4, Pika 1 dhe 2.
5. Tejkalmi i caqeve të planifikuara sipas Nenit 3, Pika 3, punonjësit do të marrin edhe stimulim nga paga bazë sipas Vendimit të KE, bazuar në Nenin 3, Pika 5.
6. Mos realizimin i caqeve të planifikuara sipas Nenit 3.2. punonjësit do të destimulohen nga paga bazë sipas Vendimit të KE, bazuar në Nenin 3, Pika 5.
7. Arkëtuesi-lexuesi mund të jepet një shumë e parave në formë të paradhënies si para e imët deri në vlerë 50€ (pesëdhjetë euro) nga ana e kompanisë në çdo fillim të vitit me qëllimin të lehtësimin të procesit të arkëtimit, të cilën punëtorët janë të obliguar ta kthejnë në muajin e fundit të vitit kalendarik, deri në aktivizimin e faturimit mobil,
8. Shuma në fjalë prej 50€ kompensohet në mënyrë automatike nga paga e fundit në vitin kalendarik apo me rastin e ndërprerjes/përfundimit të kontratës, deri në aktivizimin e faturimit mobil.
9. Për stimulim rreth angazhimeve shtesë për të cilat nuk janë paraparë me kontratë dhe rregullore, kërkesa për stimulim paraqitet nga Menaxheri i DSh dhe miratohet nga KE.

**Neni 5**

**Detyrat dhe përgjegjësitë tjera të arkëtuesve-lexuesve**

1. Lexuesi – arkëtuesi është i obliguar që një herë në muaj të bëjë leximin e matësit tek konsumatori.
2. Gjendjet e lexuara në terren nga arkëtuesi-lexuesit duhet të sjellë në kompani më së voni deri më **27 të muajit kalendarik** ose sipas lejes apo kërkesës nga ana e përgjegjës.
3. Lexuesi – arkëtuesi është i obliguar që të vizitoj konsumatorin së paku njëherë në muaj, të bëjë dorëzimin e faturës-vërejtjes dhe arkëtimin e faturave.

<sup>1</sup> Koeficienti dhe vlera e tij, përditësohen në mënyrë automatike bazuar në Organogramin e kompanisë dhe Rregulloren për Sistematizim të Vendeve të Punës

KRU BIFURKACIONI SH.A  
RREGULLORE MBI PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME PËR STIMULIM TË LEXUESVE -  
ARKËTUESVE

4. Lexuesi – arkëtuesi është i obliguar që gjatë orarit të punës të mbaj çdo kohë Kartën e Identifikimit (ID - Bexhin)
5. Lexuesi – arkëtuesi është i obliguar të raporton për çdo parregullsi në terren, në çdo kohë dhe në mënyre të përsëritshme në sistemin e njoftimeve.
6. Në rastet kur vërtetohet se ka rast që shpenzimet e ujëmatësit nuk përputhen me sistemin e faturimit deri në vlerën +/- 30 m<sup>3</sup> arkëtuesi-lexuesi nuk do të ju përlllogaritet për 3 (tre) muajt vijues stimulimi sipas Nenit 4, Pika 2.
7. Arkëtimi nga pagesat të cilat vijnë nga ekipet e shkyçjes, përmbaruesi, gjykata, AKP si dhe kushtëzimeve tjera nga ana e kompanisë, arkëtuesit do ti përlllogariten vetëm 10% e vlerës së arkëtuar.
8. Pagesat të cilat vijnë nga institucionet buxhetore nuk përlllogariten në arkëtim të lexuesit – arkëtuesit.

**Neni 6**

**Mos respektimi i detyrave dhe përgjegjësi të lexuesve – arkëtuesve dhe destimulimi**

- 7.1. Për mos realizim të planit mujor deri në masën 20%, përpos në rastet kur kemi rrethana të jashtëzakonshme ndaj lexuesit – arkëtuesit do shqiptohet masë disiplinore vërejtje me shkrim.
- 7.2. Nëse lexuesi – arkëtuesi nuk arrin të realizojë objektivat sipas Pikës 1, për (dy) muaj tjerë brenda vitit fiskal, ndaj tij do të fillon procedura disiplinore sipas ligjit të punës, për mos realizim të punëve dhe detyrave të punës dhe do të merret masa përkatëse ligjore dhe akteve tjera normative të kompanisë.

**Neni 7**

**Interpretimi**

Interpretimi i kësaj Rregulloreje është objekt i Zyrës Ligjore/Sekretarit të KRU Bifurkacioni SH.A.

**Neni 8**

**Implementimi i dispozitave**

Rregullorja mbizotëron në raport me rregulloret tjera të kompanisë të cilat rregullojnë këtë fushë dhe shfuqizon çdo vendim paraprak me të cilin ka qenë i rregulluar stimulimi i lexuesve – arkëtuesve.

**Neni 9**

**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi 8 (tetë) ditë pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve.

Datë: 22.10.2022

Ferizaj



K.R.U Bifurkacioni SH.A – Ferizaj

  
Naim Rexhaj  
Kryesues i Bordit të Drejtorëve